



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**  
**OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA**

---

**P.nr.514/2019**

**NË EMER TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore ne Mitrovice - Departamenti i përgjithshëm** Gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari Gëzim Ademi ne çështjen penale, ndaj te pandehurit: O.B për shkak te veprës penale: Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par 3 pika 3.1 te KPRK-ës, sipas Aktakuzës se P.TH. ne Mitrovice PP.II.nr.956/19 te datës 03.05.2019, tani me kualifikim Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par 1 nen par 1.4 te KPRK-ës, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt. 25.09.2019, ne mungese të PTH, në prezencë te të pandehurit ne te njëjtën dite, publikisht shpall, ndërsa me 26.09.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri: O.B, nga i ati M. e ëma N. e vajzërisë A. i lindur më ... në ..., jeton ne rrugën “...” , me nr. personal ..., Rom , Shtetas i Republikës se Kosovës , i martuar, gjendjes se dobët ekonomike.**

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Me datën 27.02.2019 rreth orës 22:00 ne ..., ka shkaktuar lëndime te lehta trupore personit te dëmtuar V.R, ne atë mënyrë qe ne natën kritike i pandehuri ka thirrur te dëmtuarën për tua sjell çelësat dhe pastaj ne një moment kur ajo ka dal nga taksi aj ka filluar ta godas me grushte ne koke dhe trup nen ndikim te alkoolit nga 1,06 promilë dhe i ka shkaktuar lëndime te lehta trupore si ndrydhje te indeve te buta ne pjesën e përparme te qafës, te cilat janë lëndime te karakterit te përkohshëm shëndetësore.

Me këtë ka kryer veprën penale: Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën par 1.4 te KPRK-se.

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,49,50,51,52,73, dhe 188 par.1 nen par 1.4 te KPRK-ës , e lidhur me nenin 365, 450 te KPRK-ës e:

**G J Y K O N**

**ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 6 (muaj), i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatjeje prej 1 (një) viti.**

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 10 Euro, për ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20 euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 30 euro, te cilat shpenzime i pandehuri është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.I.nr.956/2019 te datës 03.05.2019, kundër te pandehurit O.B nga ... me vendbanim ..., Rr "...” për shkak të veprës Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.3 nen par 3.1 te KPRK-ës. Prokuroria e shtetit ne seancën e shqyrtimit fillestar, ka ber kualifikimin e veprës penale nga vepra penale e cekur ne aktakuzë ne veprën penale Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par 1 nen par 1.4 te KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtim fillestar me dt. 25.09.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: Se e ndjej veten fajtor për veprën penale qe me vihet ne barre, njeherit me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra te tilla penale, njëkohësisht i propozoj gjykatës qe me rastin e shqiptimit te dënimit te me shqiptoj një dënim sa me te but.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori deklaron: Ne baze te nenit 248 par 2 te KPP-es duke pasur parasysh edhe pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit japi mendimin qe janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, se pranimi i fajësisë është bere ne mënyrë vullnetare, pa presion, pa kërcenim, dhe i propozoj gjykatës qe ta pranoj pranimin e fajësisë, ngase pranimi i fajësisë është i mbështetur ne provat dhe faktet qe gjenden ne shkresat e lendes, e me rastin e shqiptimit te dënimit , pranimin e fajësisë gjykata ta merr si rrethanë lehtësuese.

E dëmtuara- dëshmitarja deklaron: i propozoj gjykatës qe te pranoj pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, me rastin e shqiptimit te dënimit te pandehurit gjykata te ia shqiptoj një dënim sa me te but.

Mbrojtësi i viktimave lidhur me pranimin e fajësisë deklaron: pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne përputhje me dispozitat ligjore dhe e njëjta mbështet ne shkresat e lendes, andaj edhe unë si mbrojtës i viktimës dhe ne emër te saj i propozojmë gjykatës qe pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit ta pranoj dhe te njëjtën ta marr si rrethane lehtësuese ne shqiptimin e dënimit.

### **Vlerësimi i pranimit te fajësisë.**

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e Gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: raporti mjekësor me nr. ... te ... nga data 27.02.2019, raporti policore

nga data 27.02.2019, raporti mbi alkoolin testin nga 27.02.2019, kartela për viktimën e lëshuar nga ana e Policisë së Kosovës, mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore 17.03.2019, nga të gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Lëndim i lehte trupor nga neni 188 par 1 nene par 1.4 të KPRK-ës.

### **Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit**

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me gjobe ose me burgim deri në 1 (një) vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykate si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale, si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimit të fajësisë i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurit për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale. Po ashtu gjykata mori parasysh edhe faktin se i njëjti nuk figuron në evidencën e të dënuarve. Nga të gjitha këto gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton dënimi me kusht, nga se do të ndalojë kryerësin që të mos kryej vepra penale në të ardhmen e që ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga të gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit.

### **Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.**

Lidhur me shpenzimet procedurale- gjykata vendosi si në diapozitiv të aktgjykimit ashtu që për paushallin gjyqësor vendosi shumën prej 10 Euro, për fondit për kompensimin e viktimave shumën prej 30 Euro, Ekspertiza mjeko-ligjore 20 Euro, të gjitha këto është i obliguar që të paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **Lidhur me kërkesën pasurore juridike.**

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata të dëmtuarit i ka udhëzuar në konteste të rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,463 të KPPK-ës nga arsyeje të lartcekura ka vendosur si në dispozitivin të këtij aktgjykimi

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.514/2019 dt.26.09.2019**

Procesmbajtësja :  
**Hasnije Muhaxheri**

Gjyqtari :  
**Gëzim Ademi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë në ankese në afat prej 15 ditëve në gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.